



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 542/1 prot.

Tiranë më 9.03.2022

Lënda: Dhënie mendimi për “*Protokollin ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për krijimin e task forcave të përbashkëta*”.

### MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 2397 prot., datë 07.03.2022, administruar me tonën Nr. 542 prot., datë 08.03.2008 përmes së cilës kërkohet mendim për “*Protokollin ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për krijimin e task forcave të përbashkëta*”, në vijim gjeni qendrimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Zyra e Komisionerit*”).

Zyra e Komisionerit, në tërësi vlerëson se, projektvendimi është i hartuar konform ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”).

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, Zyra e Komisionerit sugjeron që, në pikën 1, të nenit 7, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “*Autoritetet kompetente të palëve duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Në veçanti, garantojnë se vetëm palët e autorizuara për akses në të dhënat personale mund të kenë akses në këto të dhëna*”.

Zyra e Komisionerit sugjeron gjithashtu, që në të njëjtin nen, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “*Palët dhe personat që vihen në dijeni me të dhënat personale të përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit*”.

Gjithashtu, do të kërkonim nga ana juaj, kryerjen e ndërhyrjeve aty ku është e nevojshme, për të përshtatur terminologjinë e përdorur me atë të Ligjit.

Konkretisht,

- Referuar pikës 1 të nenit 7 të projektvendimit, sugjerojmë që, paragrafi: *“Për qëllimet e zbatimit të këtij Protokoll, autoritetet kompetente të Palëve do të shkëmbejnë, përpunojnë dhe ruajnë të dhënat personale, në përputhje me legjislacionin kombëtarë përkatës”*, të riformulohet në këtë formë: *“Për qëllimet e zbatimit të këtij Protokoll, autoritetet kompetente të Palëve, gjatë shkëmbimit të informacionit, duhet të përpunojnë të dhënat personale në përputhje me legjislacionin kombëtarë përkatës”*.

- Në po këtë pikë, ku përcaktohen parimet që do të zbatohen, vlerësojmë që, togfjalëshi *“të dhënat personale duhet të jene adekuate, të përshtatshme dhe jo të gjera në lidhje me qëllimin për të cilat janë mbledhur dhe/ose përpunuar: në veçanti, të dhënat personale të specifikuar në kërkesën për posedim”*, të zëvendësohet me togfjalëshin *“të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe nuk duhet të tejkalojnë qëllimin për të cilat janë mbledhur dhe/ose përpunuar: në veçanti, të dhënat personale të specifikuar në kërkesën për posedim”*

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

